



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 2 tetor 2017
Nr. ref.: RK 1127/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI29/17

Parashtrues

Adem Zhegrova

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 343/2016, të 16 janarit 2017**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Adem Zhegrova nga komuna e Vushtrrisë (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Firma e Avokatisë "Judex" në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 343/2016, i 16 janarit 2017, me të cilin ishte refuzuar si i pabazuar revizioni i parashtruesit kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit (Ac. nr. 2042/2014) të 20 shtatorit 2016.
3. Parashtruesi i kërkesës pohon se aktgjykimin e kontestuar e ka pranuar më 8 shkurt 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon që i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në lidhje me nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe e drejta e tij e garantuar me nenin 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe nenin 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 8 mars 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën e tij në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 7 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
8. Më 14 prill 2017, Gjykata e njoftoi përfaqësuesin e parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 5 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 18 tetor 2010, parashtruesi i kërkesës u njoftua lidhur me Vendimin e Korporatës Energjetike të Kosovës, Distribucioni në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: punëdhënësi), për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Parashtruesi i kërkesës ishte njoftuar lidhur me vendimin e punëdhënësit gjatë takimit me menaxherin e distriktit.
11. Vendimi i punëdhënësit për ndërprerje të marrëdhënies së punës (në tekstin e mëtejme: vendimi i punëdhënësit) arsyetohej me kryerjen e shkeljes së rëndë të detyrave të punës nga ana e parashtruesit, gjegjësisht manipulimit të njehsorit dhe shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë elektrike, të cilat ishin konstatuar në raportin e auditimit të brendshëm.
12. Më 22 tetor 2010, kundër vendimit të punëdhënësit, parashtruesi paraqiti kundërshtim te Drejtori Ekzekutiv i punëdhënësit.
13. Më 2 nëntor 2010, Drejtori Ekzekutiv i punëdhënësit (Vendimi nr. 396) refuzoi kundërshtimin e parashtruesit të kërkesës.
14. Më 15 nëntor 2010, parashtruesi i kërkesës ushtroi padi në Gjykatën Komunale të Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Komunale), me të cilën kërkoi anulimin e vendimit të punëdhënësit si dhe kërkoi kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës apo në një vend të punës i cili i përgjigjet përgatitjes profesionale dhe kualifikimeve të tij.
15. Më 13 prill 2012, Gjykata Komunale (Aktgjykimi C. nr. 462/2010) aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit dhe obligoi punëdhënësin që ta kthej në vendin e tij të mëparshëm të punës apo në një vend të punës me detyra të cilat i përgjigjen përgatitjes profesionale dhe aftësive të parashtruesit.
16. Gjykata Komunale në aktgjykimin e saj konstatoi se vendimi i punëdhënësit është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Themelor të Punës dhe Rregullores nr. 3 të punëdhënësit, për arsye se parashtruesit *"[...] i është ndërprerë marrëdhënia e punës ende pa u vërtetuar me vendim të plotfuqishëm kryerja e veprës penale të vjedhjes kurse [Punëdhënësi] nuk arriti që Gjykatës t'i prezantoi një aktgjykim të plotfuqishëm nga Gjykata kompetente me të cilin do të vërtetohej se i njëjti është shpallur fajtor për veprën penale të vjedhjes."*
17. Më 13 nëntor 2012, punëdhënësi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale, duke pretenduar ekzistimin e shkeljeve thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, vërtetimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale.
18. Më 30 dhjetor 2013, Gjykata e Apelit (Aktvendim Ac. nr. 4926/2012) prishi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale (C. nr. 462/2010, të 13 prillit 2012) dhe ktheu lëndën për rishqyrtim dhe rivendosje. Gjykata e Apelit konstatoi se Aktgjykimi i Gjykatës Komunale është i përfshirë me shkelje thelbësore të

dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe vërtetim jo të plotë të gjendjes faktike.

19. Gjykata e Apelit, mes tjerash, arsyetoi se: “[...] procedura disiplinore është procedurë e ndarë nga procedura penale dhe se gjykata kontestimore e cila vlerëson ligjshmërinë e masës disiplinore nuk është e lidhur me aktgjykimin penal lirues përkatësisht procedurën penale.”
20. Më 23 prill 2014, Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtrri (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit C. nr. 16/14: I. Aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit; II. Anuloi vendimin e punëdhënësit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës; III. Detyroi punëdhënësin që parashtruesin ta kthejë në vendin e tij të mëparshëm të punës apo në një punë, e cila i përgjigjet kualifikimit të tij; IV. Urdhëroi punëdhënësin që parashtruesit t’ia kompensojë të gjitha pagat dhe përfitimet tjera nga dita e largimit të tij nga puna deri në ditën e kthimit të tij në punë; dhe V. Obligoi punëdhënësin që në emër të shpenzimeve të procedurës parashtruesit t’ia paguajë një shumë të caktuar.
21. Gjykata Themelore në aktgjykimin e saj konstatoi se ndërprerja e marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit është e paligjshme, për arsye se punëdhënësi nuk kishte zhvilluar procedurë disiplinore kundër parashtruesit.
22. Në këtë drejtim, Gjykata Themelore arsyetoi: “[...] në raport me Ligjin Themelor të Punës në Kosovë i cili në nenin 11 i ka paraparë në mënyrë decidive shkaqet e shkëputjes së kontratës ndërsa në nenin 26 të po këtij ligji, ka paraparë se për zbatimin e këtij ligji Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të nxjerr urdhëresa administrative. PSSP ka nxjerr Urdhëresën administrative 2003/2, për të zbatuar ligjin e punës, ku në nenet 31, 32 si dhe nenin 33 ka rregulluar në mënyrë thelbësore procedurën disiplinore.”
23. Kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, punëdhënësi parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit. Në ankesën e tij, punëdhënësi pretendoi shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
24. Më 20 shtator 2016, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi Ac. nr. 2043/14): I. Aprovoi ankesën e punëdhënësit si të bazuar; II. Ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore (C. nr. 16/14 të 23 prillit 2014); dhe III. Refuzoi kërkesëpadinë e parashtruesit si të pabazuar.
25. Në aktgjykimin e saj, Gjykata e Apelit konstatoi se me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore është zbatuar gabimisht e drejta materiale.
26. Gjykata e Apelit arsyetoi se: “Gjykata e shkallës së parë gabimisht i është referuar Urdhëresës Administrative Nr. 2003/2 për zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut NR. 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, me referencë nën nenin 26 të Rregullores Nr. 2001/27, Për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, pasi që urdhëresa administrative e cituar nuk i referohet fare zbatimit të

Rregullores Nr. 2001/27, Për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, por i referohet Rregullores së UNMIK-ut NR. 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë. Gjykata do të duhej të ketë vlerësim të qartë se në rastin konkret themelimi i marrëdhënies së punës nga ana e paditësit me të paditurën e rrjedhimisht edhe ndërprerje e punës nuk ka për bazë Rregulloren e UNMIK-ut NR. 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, por ka për bazë Rregulloren Nr. 2001/27, Për Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, pasi që këto dy rregullore përcaktojnë rregulla për dy kategori të ndryshme të subjekteve nga marrëdhënia e punës. [...]

27. *Më tej, Gjykata e Apelit iu referua Rregullores së lartcekur për Ligjin Themelor të Punës, duke nënvizuar: “Me dispozitën e nenit 11 paragrafi 1 pika c), e Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/27, për Ligjin Themelor të Punës, përcaktohet shkëputja e kontratës në raste të rënda të sjelljes së keqe të një punonjësi, ndërsa në nenin 11 paragrafi 5 pika a) parashihet se: “Punëdhënësi do ta njoftojë punonjësin me shkrim me qëllimin e tij për ta ndërprerë kontratën e punës. Ai njoftim përfshin edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës” dhe në pikën b) të nenit të njëjtë përcaktohet se: “Punëdhënësi do të mbajë takim me punonjësin me ç’rast punëdhënësi ia shpjegon me gojë punonjësit shkaqet e shkëputjes së kontratës. [...]*
28. *Më 28 tetor 2016, parashtruesi paraqiti revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, duke pretenduar zbatim të gabuar të së drejtës materiale.*
29. *Parashtruesi i kërkesës në revizionin e tij ju referua edhe Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës në Kosovë, nr. 12/1989, i cili sipas tij ka qenë po ashtu në fuqi dhe ka paraparë iniciimin e procedurës disiplinore në rast të shkeljeve të detyrave të punës apo shkeljeve tjera disiplinore. Parashtruesi i kërkesës, më tej i referohet edhe rregulloreve të brendshme të punëdhënësit, duke pohuar që dispozitat e këtyre rregulloreve përcaktojnë që përgjegjësia disiplinore e punëmarrësit vërtetohet në procedurë disiplinore.*
30. *Më 16 janar 2017, Gjykata Supreme (Rev. nr. 343/2016) refuzoi si të pabazuar revizionin e parashtruesit.*
31. *Gjykata Supreme konstatoi se “[...] aktgjykimi i goditur nuk përmban të meta të cilat kishin për të kontestuar ligjshmërinë e aktgjykimit lidhur me zbatimin e të drejtës materiale, për faktin se është i drejtë konstatimi i gjykatës së shkallës së dytë se e paditura i ka respektuar procedurat e përcaktuara ligjore me rastin e shkëputjes së kontratës së punës së paditësit të përcaktuara në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, ashtu që në bazë të nenit 11.2 pika (a) paditësi është njoftuar me njoftimin nr. 406 të datës 18.10.2010, për qëllimin e saj për t’ia ndërprerë paditësit kontratën e punës, në bazë të pikës (b) e paditura ka mbajtur takim me paditësin me ç’rast i ka shpjeguar gojarisht shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës.*
32. *Gjykata Supreme, më tej, gjeti se: “[...] me dispozitën e nenit 38.1 të kësaj rregulloreje [Rregulloren mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të*

punëdhënësit të datës 28 gusht 2008] është paraparë procedurë e shkurtë disiplinore, për shkelje të detyrave të punës nga dispozita e nenit 38.3 pika (c dhe f) për të cilat paditësi është shpallur përgjegjës. Ndërsa me nenin 39.1 dhe 2 është paraparë që procedura e shkurtër disiplinore fillohet në bazë të informatës së pranuar nga punëmarrësit tjerë dhe vrojtimit direkt nga ana e mbikëqyrësit dhe punëmarrësit. Drejtori menaxhues pasi të ketë dëgjuar punëmarrësin, mund të shqiptojë masën disiplinore – shkëputje e kontratës.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pohon se Gjykata Supreme me aktgjykimin e kontestuar *“fillimisht ka vepruar në kundërshtim me vet praktikën gjyqësore të saj, duke vendosur ndryshe për raste të njëjta”*. Në lidhje me këtë, parashtruesi konsideron se Gjykata Supreme *“nuk i ka mundësuar atij një gjykim të drejtë dhe të paanshëm”* të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
34. Më tutje, parashtruesi pohon që: *“me divergjencat e mëdha që ka shprehur Gjykata e revizionit mes vendimeve gjyqësore, [...] Gjykata Supreme me këso situatash po krijon pasiguri juridike tek qytetarët dhe zbehje të besimit në zgjidhje të drejta e të ligjshme gjyqësore.”*
35. Në lidhje me pretendimin për shkelje të nenit 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit] të Kushtetutës, parashtruesi, ndër të tjera, pohon se *“mohimi i një të drejte kushtetuese, siç është ajo e të drejtës për punë dhe aftësim profesional, konsiston në ndërprerjen e marrëdhënies së punës në mënyrë të njëanshme dhe pa paralajmërim nga ana e punëdhënësit.”*
36. Në vijim, parashtruesi pretendon, gjithashtu, ekzistimin e shkeljes së nenit 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut] të Kushtetutës duke arsyetuar se: *“[...] parashtruesi nuk ka pasur asnjëherë mundësinë që të deklarohet paraprakisht, para vendimit për shkëputje të kontratës. Kjo sepse, punëdhënësi nuk ka thirrur fare një komision disiplinor, i cili do të mundësonte nxjerrjen e një vendimi përfundimtar, të bazuar në argumentet e të dyja palëve.”*
37. Në fund, parashtruesi i kërkesës i propozon Gjykatës që:

“Të shpallë kërkesën të pranueshme;

Të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 49 (E Drejta në Punë dhe Aftësim Profesional), nenin 55 (Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive të Njeriut), neni 31 (E Drejta e tij Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenin 53 (Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut) të Kushtetutës së Kosovës.

Të konstatojë se ka pasur shkelje të nenit 6.1 (E drejta për proces të rregullt) të Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut.

Të shpallë të pavlefshëm Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 343/201, i 16 janarit 2017, dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Ac. nr. 2043/ 2014, të dt. 20 shtator 2016.”

Pranueshmëria e kërkesës

38. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

39. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuar] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

40. Gjykata vëren se parashtruesi është palë e autorizuar në pajtim me Kushtetutën, ka shteruar të gjitha mjetet e nevojshme juridike, si dhe ka dorëzuar kërkesën e tij brenda afatit 4 (katër) mujor pas pranimit të aktgjykimit.

41. Megjithatë, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

42. Gjykata po ashtu rikujton rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, [...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

43. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon që aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme ka shkëlur të drejtën e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si dhe të drejtat e tij të garantuara me nenet 49 [E Drejta në Punë], 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] dhe 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore] të Kushtetutës.
44. Megjithatë, Gjykata konsideron se pretendimet e ngritura nga parashtruesi, në thelb, i referohen të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
45. Gjykata vëren se, për të mbështetur pretendimin e tij se Gjykata Supreme *“duke vendosur ndryshe në raste të njëjta po krijon pasiguri juridike tek qytetarët dhe zbehje të besimit në zgjidhje të drejta e të ligjshme gjyqësore,”* parashtruesi i kërkesës i referohet Aktgjyqimit Rev. nr. 62/2014 (të 20 marsit 2014). Në lidhje me këtë, parashtruesi i kërkesës, i referohet edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, veçanërisht rastit KI89/13, *Arbresha Januzi*, Aktgjykim i 22 prillit 2014.
46. Fillimisht, Gjykata i referohet nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, i cili përcakton që *“të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
47. Gjykata rikujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) e cila *inter alia*, ka theksuar: *“[...] përveç në rast të arbitraritetit të dukshëm, nuk është roli i Gjykatës që të vë në pikëpyetje interpretimin e të drejtës vendore nga gjykatat shtetërore (shih, Adamsons kundër Letonisë, Nr. 3669/03, 10 maj 2007). Ngjashëm, në këtë kuptim, parimisht nuk është funksioni i saj që të krahasojë vendimet e ndryshme të gjykatave vendore, edhe nëse janë nxjerrë në procedura dukshëm të ngjashme; gjykata duhet të respektojë pavarësinë e atyre gjykatave [...]”* (Aktgjykim i GJEDNJ i 20 tetorit 2011, *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, nr. 13279/05, paragrafi 50).
48. Gjykata vë në pah se parashtruesi në mënyrë specifike i referohet një Aktgjykimi të Gjykatës Supreme (Rev. nr. 62/2014 të 20 marsit 2014) të dorëzuar në Gjykatë, me të cilin Gjykata Supreme kishte pranuar si të themeltë revizionin e një ish-punonjësit të punëdhënësit. Sipas parashtruesit të kërkesës, ky aktgjykim ka të bëjë me situatë faktike të ngjashme si me atë të parashtruesit.
49. Gjykata vëren se Gjykata Supreme, përmes aktgjyqimit të lartcekur (Rev. nr. 62/2014 të 20 marsit 2014), duke ju referuar edhe Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës në Kosovë 12/1989, kishte prishur Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, duke konstatuar se punëdhënësi është dashur të iniciojë procedurë disiplinore. Si rrjedhojë, Gjykata Supreme kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë (Gjykatës Komunale në Vushtrri), me të cilin kërkesëpadia e ish-punonjësit të punëdhënësit për kthim në vendin e tij të mëparshëm të punës apo në një pozitë e cila i përgjigjet kualifikimeve të tij ishte aprovuar si e bazuar.

50. Në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës, Gjykata sërish i referohet praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila ka pranuar se: *“Një shkallë e caktuar dallimesh në interpretimet ligjore [nga gjykatat] mund të pranohet si një tipar i qenësishëm i çdo sistemi gjyqësor [...] Megjithatë, dallimet thelbësore dhe për një kohë të gjatë në praktikën e gjykatave të larta vendore mund të jenë vetvetiu në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike (shih rastet e GJEDNJ-së, Beian kundër Rumanisë, kërkesa nr. 30658/05, Aktgjykim i 6 marsit 2008, paragrafi 39 dhe Tomić dhe të tjerët kundër Malit të Zi, kërkesat nr. 18650/09, 18676/09, 18679/09, 38855/09, 38859/09, 38883/09, 39589/09, 39592/09, 65365/09 dhe 7316/10, Aktgjykim i 17 prillit 2012, paragrafi 53).*
51. Sidoqoftë, GJEDNJ përmes praktikës së saj gjyqësore ka përcaktuar kriteret për vlerësimin e kushteve në të cilat vendimet kundërthënëse të gjykatave të shkallës së fundit janë në kundërshtim me të drejtën për gjykim të drejtë, përkatësisht duhet vërtetuar nëse ekzistojnë dallime të thella dhe të vazhdueshme në praktikën gjyqësore të gjykatave të vendit, nëse ligji i vendit parashikon mekanizëm për tejkalimin e këtyre mospërputhjeve, nëse ky mekanizëm është zbatuar dhe nëse po, deri në çfarë mase (Shih *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së *Jordan Jordanov dhe të tjerët kundër Bullgarisë*, Kërkesa nr. 23530/02, Aktgjykim i 2 tetorit 2009, paragrafët 49-52).
52. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se parashtruesi i referohet dhe ka dorëzuar vetëm një Aktgjykim të Gjykatës Supreme (Rev. nr. 62/2014, të 20 marsit 2014), e cila në rrethanat e ngjashme faktike ka interpretuar ndryshe të drejtën materiale.
53. Rrjedhimisht, si dhe në dritën e praktikës së GJEDNJ-së, Gjykata vlerëson se nuk është e mundur të konstatohet ekzistimi i dallimeve të thella dhe të vazhdueshme në praktikën gjyqësore të Gjykatës Supreme që rrezikojnë parimin e sigurisë juridike, duke u thirrur vetëm në një Aktgjykim të Gjykatës Supreme, të nxjerrë 3 (tri) vite më herët.
54. Në vijim, Gjykata rikujton se parashtruesi pretendon se në rastin e tij shkëputja e marrëdhënies së punës nga ana e punëdhënësit është e paligjshme për arsye se punëdhënësi nuk kishte iniciuar procedurë disiplinore.
55. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se parashtruesi, duke ju referuar edhe Ligjit mbi Marrëdhëniet e Punës në Kosovë 12/1989, këtë pretendim e kishte ngritur edhe në kërkesën e tij për revizion në Gjykatën Supreme.
56. Gjykata Supreme, në aktgjykimin e saj, kishte konstatuar se Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit nuk përmban të meta të cilat do ta kishin kontestuar ligjshmërinë e aktgjyimit të goditur. Në lidhje me këtë, Gjykata Supreme konstatoi se Gjykata e Apelit në mënyrë të drejtë ka konstatuar se punëdhënësi me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së parashtruesit i ka respektuar procedurat e përcaktuara ligjore të përcaktuara me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/27 mbi Ligjin Themelor të Punës në Kosovë, si dhe me

Rregulloren e brendshme të punëdhënësit mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale.

57. Më tej, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është i arsyetuar dhe se interpretimi i Gjykatës Supreme, sa i përket fakteve të paraqitura për vlerësim nga parashtruesi, nuk mund të thuhet se ishte arbitrare, i paarsyeshëm apo të ketë mundur të ndikojë në gjykim të drejtë, por ishte thjesht çështje e zbatimit të ligjit (shih *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë*, nr. 13279/05, paragrafi 93).
58. Prandaj, Gjykata konsideron se as numri i aktgjykimeve të pretenduara si kundërrthënëse, as periudha kohore brenda së cilës janë nxjerrë këto aktgjykime, si dhe as mënyra se si Gjykata Supreme ka trajtuar dhe arsyetuar rastin e parashtruesit, nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të arsyetuar pretendimin për shkelje të së drejtës së parashtruesit së kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.
59. Si rrjedhojë, Gjykata gjen se parashtruesi nuk i ka mbështetur pretendimet e tij për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së (Shih rastin *Vanek kundër Republikës Sllovaqe*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005).
60. Gjykata më tej rikujton se parashtruesi pretendon shkelje të neneve 49, 53 dhe 55 të Kushtetutës. Në lidhje me këtë, Gjykata vë në dukje se fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, si dhe vetëm përmendja e neneve përkatëse të Kushtetutës pa shtjelluar shkeljen e pretenduar të tyre, nuk është e mjaftueshme që parashtruesi i kërkesës të ndërtojë një pretendim të mbështetur për shkelje kushtetuese. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të sigurojë një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 33).
61. Për më tepër, përkitazi me pretendimin e parashtruesit për shkelje të drejtës së punës dhe ushtrimin të profesionit, Gjykata konsideron se aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme në asnjë mënyrë nuk e ndalon parashtruesin e kërkesës të punojë ose të ushtrojë profesionin. Si rrjedhojë, nuk ekziston asgjë në pretendimin e parashtruesit që do të arsyetonte përfundimin se është shkelur e drejta e tij kushtetuese në punë dhe aftësim profesional (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI136/14, *Abdullah Bajqinca*, Aktvendim për papranueshmëri i 10 shkurtit 2015, paragrafi 34).
62. Nga arsyet e mësipërme, Gjykata përfundon se faktet e paraqitura nga parashtruesi në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin e tij për shkelje të neneve 31, 49, 53 dhe 55 të Kushtetutës, dhe se parashtruesi i kërkesës nuk ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimet e tij.
63. Prandaj, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, rrjedhimisht, e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 shtator 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Bekim Sejdiu



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi